

C.nr.162/2015

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti Përgjithshëm Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë kontestimore, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditësve [REDACTED], [REDACTED], nga Fshati [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], nga Shtimja, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit avokatit [REDACTED] nga Prishtina, kundër të paditurës [REDACTED]"- në Prishtinë, të cilën e përfaqëson [REDACTED], baza e kontestit-kompensimin i dëmit, më dt. 24.03.2016 mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkespacia e paditësve, [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], me të cilën kanë kërkuar të **DETYROHET** e paditura [REDACTED]" me seli në Prishtinë që t'ua paguaj shumat si vijon: Paditëses [REDACTED] për dhimbje fizike trupore shumë prej 2.800 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 2.900 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 80,00 E, në emër ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 100,00, për dëmtimin e garderobës personale shumë prej 120,00 euro, Paditëses [REDACTED], për frikën e përjetuar shumë prej 750 euro, Paditëses [REDACTED] për dhimbje fizike trupore shumë prej 2.650 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 2.750 euro, për shkak të ushqimit të përforcuar shumë prej 80,00 euro, për shkak të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 100,00 euro, për shkak të shërimit klimatik-fizikal shumë prej 220 euro, për shkak shpenzimeve të mjekimit shumë prej 140 euro, për shkak të dëmtimit të garderobës shumë prej 120,00 euro, Paditësit [REDACTED] për dhimbje fizike trupore shumë prej 2.800 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 3.100 euro, kurse në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 160,00, për shkak të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 250,00 euro, për shkak të shërimit klimatik fizikal shumë prej 220 euro, për shkak të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 189.50 euro, për shkak të dëmtimit të garderobës shumë prej 120 euro, Paditësit [REDACTED] për dhimbje fizike trupore shumë prej 2.800 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 3.100 euro, kurse në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 160,00, për shkak të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 250,00 euro, për shkak të shërimit klimatik fizikal shumë prej 220 euro, për shkak të dëmtimit të garderobës shumë prej 120 euro, të gjitha këto me kamatë prej 12 % duke filluar prej 30.11.2011, e gjerë në pagesën e plotë, si dhe refuzohet edhe kërkesa e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura [REDACTED] me seli në Prishtinë që tua kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në lartësi të specifikuar nga i autorizuari paditësve në seancën e datës 06.07.2012.

II. Detyrohen paditësit [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], që të paditurës [REDACTED]" secili prej tyre në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajnë shumë prej nga 79.56 euro

,kurse detyrohet paditësja [REDACTED] që në emër të të miturës [REDACTED] të paditurës [REDACTED] t'ia paguaj shumën e të hollave prej 79.56, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

[REDACTED], nëpërmjet të autorizuarit të tyre av. [REDACTED] nga Prishtina kan kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura [REDACTED] t'ua paguaj shumat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kurse në seancën e datës 09.03.2016, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve av. [REDACTED] nga Prishtina ka deklaruar : e tërheqi kërkesëpadin e parashtruar ,kundër të paditurës [REDACTED] me seli në Prishtinë ,për kompenzimin e dëmit ,për të gjithë paditësit dhe njëherit nuk kërkoj vendim të posaqshëm.

Gjykata duke u bazuar nga fakti se i autorizuari i paditësve ka tërhequr kërkesëpadin ,bazuar edhe në dispozitivin e nenit 149 të LPK-së ,vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykatai duke u bazuar edhe në dispozitivin e nenit 452,454 të LPK-së, si dhe tarifen e OAK-ut ka detyruar paditësit që të paditurës [REDACTED] t'ia kompenzojnë shpenzimet e procedurës për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të të paditurës avokati [REDACTED] në tri seanca gjyqësore, njëra prej së cilës është shtyer ,si dhe për përgjegji në padi, duke u bazuar në faktin se përfaqësuesi i të paditurës avokati [REDACTED] ka qenë prezent në seancat gjyqësore të përmendura dhe ka parashtruar përgjegji në padi ,si dhe ka parashtruar kërkesë për pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore ,kurse paditësit përkundër faktit që e kan inicuar këtë kontest e kan tërhequr kërkesëpadin ,pra nuk kan pasur sukses në procesin gjyqësorë të filluar kundër të paditurës [REDACTED]. Paditësja [REDACTED] po ashtu është e obliguar të kompenzojë shpenzimet e procedurës të shkaktuara nga iniciimi i procedurës që e ka barë në emrin e saj dhe në emrin e të miturës ,kjo edhe për shkak se e mitura nuk ka zotësi veprimi dhe për obligimet e krijuara në emrin e saj përgjigjet përfaqësuesja ligjore tani nëna e saj [REDACTED].

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmjet të kësaj gjykate.



REPUBLIKA E KOSOVES
 DIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 OLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 KATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC.
 03.05.2016
 [Handwritten signature]